

UDHËZIM
Nr. 64, datë 4.2.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR DOKUMENTACIONIN
E NEVOJSHËM, FORMËN DHE MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS PËR
HEQJEN DORË DHE RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE, PËR PERSONAT
QË BANOJNË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**
(Ndryshuar me udhëzimin nr. 199, datë 12.4.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 17, të ligjit nr. 113/2020 “Për shtetësinë”,

UDHËZOJMË:

I. APLIKIMI PËR RIFITIMIN DHE HEQJEN DORË NGA SHTETËSIA SHQIPTARE

Aplikimi për rifitim dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare për shtetasit shqiptar me banim jashtë territorit të RSH-së, bëhet pranë përfaqësive diplomatike dhe konsullore të RSH-së, ku ka vendbanim aplikuesi, ose në Përfaqësinë, e cila mbulon shtetin ku ka vendbanim aplikuesi, në rastet kur nuk ka përfaqësi diplomatike ose konsullore të RSH-së të hapur aty.

II. DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR HEQJE DORË TË SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Për shtetasit mbi moshën 18 vjeç kërkohen këto dokumente:

- a) kërkesa e shtetasit shqiptar drejtuar Presidentit të Republikës;
- b) premtimi nga autoriteti kompetent i shtetit akomodues ose dokument shtetësie origjinal, marrë në shtetin përkatës;
- c) certifikata e lindjes së aplikuesit*;
- ç) certifikata familjare e aplikuesit*;
- d) vërtetimi i gjendjes gjyqësore*;
- dh) vërtetimi nga gjykata e rrethit*;
- e) vërtetimi nga prokuroria e rrethit*;
- ë) vërtetimi nga zyra e përmbartimit*;
- f) dokumenti që vërteton rezidencën, vendbanimin e tij në shtetin premtues të shtetësisë tjetër (në çdo rast, ky dokument duhet të jetë për të gjithë anëtarët e familjes);
- g) mandatpagesa.

2. Për fëmijët 0–14 vjeç kërkohen këto dokumente:

- a) kërkesa e prindërve drejtuar Presidentit të Republikës;
- b) certifikatë lindje e fëmijës me shtetësi shqiptare;
- c) deklaratë noteriale e të dy prindërve (ose vetëm njërit prej prindërve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre (kur aplikohet për fëmijët e tyre deri në moshën 18 vjeç, të cilët duhet të kenë premtim shtetësie të shtetit të huaj).

3. Për fëmijët 14–18 vjeç kërkohen këto dokumente:

- a) kërkesa drejtuar Presidentit të Republikës duhet të firmoset nga vetë aplikuesi;
- b) dokumentacioni duhet të paraqitet i plotë sipas përcaktimeve të pikës paragrafi II, pika 1, për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare;
- c) deklarata noteriale e të dy prindërve (ose vetëm njëri prej prindërve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së

tyre).

Koment. Dokumentet, të cilat kanë shenjë "X" merren në Republikën e Shqipërisë.

III. DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE:

- a) kërkesa drejtuar Presidentit të Republikës;
- b) certifikatë lindje dhe familjare*;
- c) deklaratë noteriale nga çdo aplikant mbi moshën 14 vjeç, për faktin e aplikimit ose jo për të fituar shtetësi tjetër;
- ç) vërtetimin e njësisë administrative përkatëse për çdo aplikant mbi moshën 14 vjeç*;
- d) certifikatë lindje ose vdekje të prindërve të çdo aplikanti*;
- dh) fotografi e aplikantit, copë 3 tre (në rast se ka fëmijë nën moshë 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre);
- e) mandatpagesa.

Ish-shtetasi shqiptar, që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe ka fituar një shtetësi tjetër, depoziton:

- a) kërkesa drejtuar Presidentit të Republikës;
- b) certifikatë lindje dhe familjare;
- c) dëshmi penaliteti marrë në vendin e shtetësisë tjetër;
- ç) vërtetim i gjendjes gjyqësore marrë në Republikën e Shqipërisë;
- d) dokument i cili vërteton heqjen dorë nga shtetësia shqiptare.

Koment. Dokumentet, të cilat kanë shenjë "X" merren në Republikën e Shqipërisë.

IV. FORMA DHE MËNYRA E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS

1. Aplikimi për rifitim dhe heqje dorë të shtetësisë shqiptare është individual, përveç të miturve deri në moshën 14 vjeç, për të cilët shprehen prindërit e tyre.

2. Aplikimi për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, mund të kryhet edhe nga përfaqësuesi i aplikantit me prokurë të posaçme.

3. Kërkesa i drejtohet Presidentit të Republikës dhe duhet të përmbajë:

- a) emër;
- b) mbiemër;
- c) datëlindje;
- ç) vendlindje;
- d) adresa e përhershme;
- dh) adresa e përkohshme;
- e) adresa ku pret informim për ecurinë e aplikimit të tij;
- ë) arsyet e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare;
- f) në çfarë viti ka ardhur në Shqipëri;
- g) profesionin që ka pasur kur ka qenë në shtetin e huaj dhe profesionin që ushtronte në Shqipëri;
- gj) aplikanti duhet të sqarojë gjithë veprimtarinë e jetës së tij, duke u shprehur qartë;
- h) kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër, firmë dhe datë nga aplikuesi.

4. Shtetasi shqiptar ka të drejtë të heqë dorë nga shtetësia shqiptare vetëm nëse:

- a) ka një shtetësi tjetër;
- b) ka fituar një shtetësi tjetër;
- c) i është garantuar dhënia e një shtetësie tjetër nga organet kompetente të shtetit të huaj.

V. RREGULLA DHE PROCEDURA TË PËRGJITHSHME

1. Të gjitha dokumentet pranohen origjinale, kur janë në harmoni të plotë me njëri tjetrin, pa gabime e pa korrigjime. Dokumentet e marra në shtetin tjetër, sipas praktikës së procesit të legalizimit, duhet të jenë të legalizuar dhe me vulë apostile. Gjithashtu, këto dokumente duhet të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të jenë të noterizuara, vërtetimi ose certifikimi i përkthimit nga noteri shqiptar ose përfaqësitë diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë.

2. Dokumentet e lëshuara nga shteti shqiptar duhet të mos kapërcejnë tre muajt e fundit nga data e lëshimit të tyre. Dokumentet e lëshuara nga shteti i huaj (premtimi i shtetësisë, vërtetim banimi/qëndrimi ose çdo dokument tjetër i lëshuar nga shteti tjetër), kanë vlefshmëri jo më shumë se 2 (dy) vitet e fundit.

3. Të gjitha dokumentet e lëshuara në Republikën e Shqipërisë, pranohen kur janë nënshkruar nga titullari i institucionit që i lëshon ato. Këto dokumente nuk kanë nevojë për vulë apostile apo legalizim në Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në Shqipëri.

4. Të gjitha dokumentet e lëshuara në Republikën e Shqipërisë do të pranohen me vulë digjitale ose të printuara dhe të firmosura nga konsulli në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSH-së.

5. Për aplikuesit e martuar, në dokumentet e lëshuara nga zyrat e Gjykatës, Prokurorisë, Përmbarrimit dhe ato të Gjendjes Gjyqësore (dëshmi penaltetit), duhet të figurojnë të dy mbiemrat, nëse aplikuesi/ja ka marrë dhe mbiemrin e bashkëshortit/es.

6. Dokumentet e depozituara (në rastet kur nuk ka mangësi), në momentin e pranimit nga përfaqësia diplomatike ose konsullore e RSH-së, janë të vlefshëm deri në shqyrtim të aplikimit nga institucionet kompetente.

7. Depozitimi i dokumenteve nga aplikuesi, duhet të shoqërohet nga përfaqësia diplomatike ose konsullore e RSH-së, me procesverbalin e dokumenteve që përmban dosja e aplikuesit/es.

8. Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSH-së duhet të depozitojnë procesverbalin dhe dosjen e dokumenteve të aplikimit brenda 1 (një) muaji nga data e dorëzimit pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, e cila duhet të kalojë praktikën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Ministrinë e Brendshme.

9. Ministria e Brendshme njofton Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për procedurën e nxjerrjes së dekretit.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Brendshme, për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Punëve të Jashtme nr. 6252, datë 10.12.2001 dhe i Ministrisë së Rendit Publik nr. 3583, datë 27.11.2001, "Për procedurat dhe dokumentacionin për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare", i ndryshuar, dhe udhëzimi i përbashkët nr. 4573/3, datë 12.7.2013 "Për procedurat, afatet dhe dokumentacionin e kërkesave për njohje të shtetësisë shqiptare, shqyrtimin e tyre, si dhe formën dhe mënyrat e plotësimit të kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare", shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Olta Xhaçka